



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNALNA SKUPŠTINA / MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE  
SKENDERAJ

Nr. \_\_\_\_\_  
No. 04-052/d1-cccc906/25  
Data \_\_\_\_\_  
Data 08-01-2025



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Direkcija za Finansije Privredu i Razvoj  
Department of Finance Economy and Development

## RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Janar 2025

## Qëllimi

Raportimi për punët e kryera nga DBF-ja për vitin 2024

### 1. Përmbledhje

Gjate vitit 2024 janë kryer punët në harmoni me Statutin Komunal, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, Ligjin nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Ligjin mbi Financat Lokale, udhëzimeve administrative nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në baze të kompetencave dhe përgjegjësi që dalin nga to dhe bazuar në Planin e punës së aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2024

#### 1.1. Sektori për Buxhet dhe Financa

- Janë hartuar Pasqyrat Financiare vjetore për vitin 2023 dhe dorëzuar me kohë në MFPT.
- Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2024,
- Është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2023 dhe vitet tjera (344,349.32 € dhe janë destinuar sipas vendimeve të Kuvendit Komunal) në vitin 2024.
- Me kohë ka filluar implementimi i realizimit të shpenzimeve në sistemin Fre-Balance.
- Janë bërë raporte financiare periodike për tërë vitin 2024 (tri) dhe prezantuar e përkrahur në Kuvendin Komunal si dhe raporti përfundimtar për vitin 2024,
- Është përgatitur dhe aprovuar në Kuvend Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027
- Është bërë planifikimi i buxhetit për vitin 2025-2027 në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit aktiv në këtë proces të paraparë me Ligjin mbi MFPP.
- Barazimi i rregullt i shpenzimeve me MF dhe të hyrave në baza mujore,
- Është bërë bartja e mjeteve të pashpenzuara nëpër tremujor 2024 në tremujoret e ardhëm për shpenzim brenda vitit 2024, shumica në tremujorin e fundit,
- Janë regjistruar në mënyrë të vazhdueshme asetet e komunës, është bërë verifikimi (numrimi) i rregullt i tyre dhe në bashkëpunim me përgjegjësit e programeve (drejtoret e drejtorive) janë formuar komisionet për regjistrimin e aseteve, si dhe komisionet për zhvlerësimin dhe hedhjen jashtë përdorimi të aseteve.
- Është punuar në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë tjera e në rend të parë me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit në përfshirjen e projekteve më të prioritetit në buxhetin e vitit 2024 të komunës

#### - të hyrat vetanake

Të hyrat vetanake në periudhën janar - dhjetor 2024, si burim i financimit të buxhetit komunal janë realizuar sipas burimeve të lejuara me ligjin për Financa të Pushtetit lokal. Qëllimi kryesor ishte realizimi sipas planit për mbulimin e shpenzimeve të cilat rrjedhin nga planifikimi vjetor i buxhetit për këtë pjesë, miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Bazë për grumbullimin e të hyrave vetjake është Ligji i Financave të Pushtetit Lokal dhe Rregullorja komunale mbi taksat, tarifatat dhe gjobat.


Të hyrat vetjake të realizuara në periudhën janar – dhjetor 2024, krahasuar me vitin paraprak 2023, dhe planifikimin buxhetor për të njëjtin sipas tabelës në vijim:

**a. Realizimi i të hyrave sipas programeve (drejtorive),**

Pasqyra e mëposhtme prezanton të hyrat e realizuara, krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe planifikimin për vitin 2024.

Nr.	Programet / Drejtoritë	Kodi	Plani buxhetor 2024	Realizimi 2024	Realizimi 2023	% e realizimit	Struktura e real. ne %
1	2		3	4	5	6	7
1	Administrata dhe personeli	16323	72,590.00	<b>64,202.04</b>	57,936.85	88.44	3.64
2	Inspektimi	16645	9,620.00	<b>8,505.00</b>	10,079.30	88.41	0.48
3	Buxhet e Financë	17523	506,221.00	<b>326,452.37</b>	476,192.13	64.49	18.52
4	Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi	48023	34,600.00	<b>28,545.00</b>	24,600.00	82.50	1.62
5	Shërbimet Publike e Mbrojtja Civile	18023	950.00	<b>5,368.60</b>	1,105.00	565.12	0.30
6	Bujqësi dhe zhvillim rural	47023	39,080.00	<b>12,386.80</b>	51,939.67	31.70	0.70
7	Gjeodezia, Kadastrri dhe Prona	65315	156,930.00	<b>331,503.26</b>	274,143.42	211.24	18.81
8	Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit	66620	664,738.00	<b>694,017.11</b>	799,124.62	104.40	39.37
9	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	73032	26,300.00	<b>16,761.00</b>	14,634.00	63.73	0.95
11	Shtëpia e shëndetit QKMF	74400	31,150.00	<b>36,823.00</b>	31,544.00	118.21	2.09
12	Kultura, Rinia e Sporti	85023	4,180.00	<b>522.00</b>	664.00	12.49	0.03
13	Arsimi – qerdhja e fëmijëve	92650	73,030.00	<b>52,829.00</b>	44,669.00	72.34	3.00
14	Të hyrat nga gjokat në trafik dhe te Gj.		264,882.00	<b>184,781.50</b>	149,061.00	69.76	10.48
	<b>Total</b>		<b>1,884,271.00</b>	<b>1,762,696.68</b>	<b>1,935,692.99</b>	<b>93.55</b>	<b>100.00</b>

Grafiku: Struktura e të hyrave sipas drejtorive



Nga tabela e mësipërme shihet realizimi i të hyrave vetjake (kolona 4) sipas drejtorive (bartëse të, të hyrave) krahasuar më planin buxhetor 2023 (kolona 3), dhe realizimin e vitit paraprak 2023, të (kolona 5). Kolona 6 paraqet përqindjen e realizuar ne raport me planin 2024, kolona 7 paraqet pjesëmarrjen ne përqindje sipas drejtorive ne realizimin e të hyrave totale.

Sa për analizë po përmendim: DBF-ja merr pjesë me 18.52 % ne realizimin total të të hyrave , urbanizmi 39.37 %, gjokat e gjykatave 10.48 %, administrata e përgjithshme 3.64 %, gjeodezia 18.81 % etj.

Realizimi i planit buxhetor të, të hyrave vetjake në këtë vit është 93.55 %. ne raport me planin buxhetor.

Ne detaje raportimi i të hyrave vetanake sipas llojit është përgatite në raportin e buxhetit vjetor 2024.

#### b. Punë tjera;

- Është bërë, me kohë barazimi mujor, dhe për periudhat e caktuara llogaritare në Departamentin e Thesarit në MF, janë bërë pjesërisht barazimet mujore me drejtoritë komunale që realizojnë të hyra, dhe të njëjtën kohë janë transferuar – alokuar gjithë të hyrat e realizuara sipas pozicioneve të planifikuara buxhetore me përjashtim të hyrave të të hyrave që kanë tejkaluar planin 2024 dhe do të barten për shpenzim në vitin 2025.

## 2. Sektori i Tatimit në Pronë

Ky sektor gjatë vitit 2024 ka punuar dhe zbatuar dispozitat Ligjore sa i përket fushëveprimtarisë së tatimit në pronë si:

- Menaxhimin e informatave për pronën
- Rexhistrimin dhe rianketimin e pronave
- Inkasimin e tatimit për pronën dhe
- Punët tjera administrative për pronën si ankesat e obliguesve etj.

Gjatë këtij viti stafi punues i këtij sektori është angazhuar në zbatimin e detyrave të planit për vitin 2023, duke filluar nga mbledhja e të dhënave(regjistrimin) e pronave të reja si dhe verifikimin e pronave të regjistruara më parë për ndryshimet eventuale në atë pronë, inkasimin e tatimit në pronë duke përdorë format Ligjore për inkasim, azhurimin e informatave të ofruara për rexhistrim në programin e tatimit në pronë si dhe punë tjera administrative sipas kërkesave të obliguesve tatimor dhe detyrës zyrtare.

Realizimi i tatimit në pronë për vitin 2024 krahasuar me 2023

### Plani dhe realizimi i Tatimit në Pronë për vitin 2024

Nr.	Muaji	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Realizimi 2023	% e realiz. me plan	Krahasimi 2023/2024
1	Janar	19,000.00	12,791.08	17,448.32	67.32	-36.41
2	Shkurt	25,000.00	6,422.43	19,144.63	25.69	-198.09
3	Mars	40,000.00	7,856.80	24,277.83	19.64	-209.00
4	Prill	39,000.00	48,560.19	82,376.84	124.51	-69.64
5	Maj	40,000.00	19,536.03	56,407.66	48.84	-188.74
6	Qershor	35,000.00	6,593.38	25,775.38	18.84	-290.93
7	Korrik	35,000.00	11,181.05	37,702.76	31.95	-237.20
8	Gusht	45,000.00	25,049.41	54,396.27	55.67	-117.16
9	Shtator	30,000.00	16,027.20	25,500.01	53.42	-59.10
10	Tetor	20,000.00	27,015.27	13,498.63	135.08	50.03
11	Nentor	27,000.00	12,943.98	8,874.02	47.94	31.44
12	Dhjetor	30,000.00	23,484.55	9,483.57	78.28	59.62
	<b>Totali</b>	<b>385,000.00</b>	<b>217,461.37</b>	<b>374,885.92</b>	<b>56.48</b>	<b>-72.39</b>

Si shifet nga tabela krahasuese realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë në vitin 2024 ka shënuar rënie në krahasim me vitin 2023 prej 72.39 %, ndërsa ne raport me planin është realizua 56.48 %. Kjo rënie është edhe si rezultat i faljes së borxhit deri në 100.00 € për të gjithë obliguesit e këtij tatimi sipas ligjit nr. 08/L-224, neni 11/B dhe të gjithë obligimet e kryera gjatë vitit 2023 deri në atë shumë janë llogaritur si parapagime.

**Aktivitetet e kryera në mënyrë tabelare:**

<b>A. Anketuesit e pronave (inspektimi i pronave)</b>		<b>Numri i aktiviteteve</b>
1	Anketimi i pronave të reja	504
2	Ri-anketimi i pronave ekzistuese (modifikime)	2180
3	Rajonet e ankëtuara Skenderaj dhe fshatrat e Komunës	26
4	Paisja me foto e objekteve	950
<b>B. Zyra për inkasim të Tatimit në pronë</b>		<b>Numri i aktiviteteve</b>
1	Kontakte me Tatim pagues	266
2	Përgatitja e njoftimeve përfundimtare	402
3	Shpërndarje e Njoftimeve të të gjithë obliguesit tatimor	246
4	Marrëveshje me Tatimpagues me z. e inkasimit	37
5	Vendime për ekzekutim të obligimeve	26
<b>C. Operatorët e futjës së të dhënave në sistem dhe zyrtari për ankesa</b>		<b>Numri i aktiviteteve</b>
1	Vërtetime, Certifikata, fatura etj.	2850
2	Plotësimi me numra personal për çdo Tatim Pagues	830
3	Evidentimi i obliguesve të mëdhenjve	512
4	Kontrata shitbl. nga dt. nga D.G.J.K .	114
5	Ankesa të pranuar dhe të verifikuara në teren	49

Skenderaj 08.01.2025

Drejtori për Buxhet dhe Financa  
Ismet Aliu

